

AKT - THEMELIMI
I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“DARKCORE TECHNOLOGY & SOFTWARE” SHPK

Bazuar në vullnetin e ortakëve themelues dhe mbështetur në Ligjin 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, ndryshuar me Ligjin nr. 10475, datë 27.10.2011 vendoset si me poshtë:

Kreu I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja dhe Selia e Shoqërisë.

Neni 1:

Themelimi, Themeluesit, Emri.

Sot më datë 15.01.2025 themelohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar me emrin: “DarkCore Technology & Software”shpk

Themeluesi i shoqërisë “**DarkCore Technology & Software**” është **Z. Denis Malushi**, shtetas shqiptar, lindur dhe banues në Tiranë, i datëlindjes 17.05.1987, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, pajisur me ID/Pasaporte nr.personal: I70517116P, i cili redaktoi këtë Akt-Themelimi, në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë nr. 9901 datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar dhe ligjit 9723 datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar.

Neni 2

Objekti i veprimtarise

Zhvillim dhe mirembajtje sistemesh software. Programimi i sistemeve software, kodimi, instalimi, integrimi i te gjithë komponenteve, dokumentimi, identifikimi dhe korrigjimi i gabimeve, mirembajtja e te gjithë komponenteve. Aktivitete per implementime konfigurime dhe mirembajtje te platformave te ndryshme, database, middleware, BI, data warehouse IoT, AI, projekte ICT si dhe çdo aktivitet tjeter në fushën e teknologjisë së informacionit dhe shërbimeve kompjuterike.

Neni 3

Kohëzgjatja e shoqërisë

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një periudhë të pacaktuar.

Neni 4

Selia e shoqërisë

Shoqëria e ka selinë e saj në adresën: Selia e shoqërisë është në adresën: Njësia nr.7, Rruga “Muhamed Gjollësia”, Sheshi Karl Topia, Tirana Ring Center, kuota +0.00, Tiranë, Shqipëri”.

Kreu II

Kapitali i shoqërisë

Neni 5

Vlera dhe pagesa e kapitalit të paguar

Kapitali themelor i shoqërisë është caktuar në shumën 300,000 (treqind mijë) lekë. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e tyre si vijon :



Lloji i kontributit është në para në vlerën 300,000 (treqind mijë) lekë, i ndarë në 1 (një) kuotë si më poshtë;

- **Z. Denis Malushi**, është zotërues i 1 (një) Kuote, që i korrespondon 100 % (njëqind për qind) të Kapitalit të Shoqërisë.
- Kapitali themeltar i shoqërisë është shlyer dhe nënshkruar teresisht nga ortaku i shoqërisë.

Kreu III
Administratori i shoqërisë.

Neni 6
Emerimi dhe kohezgjatja e Administratorit.

Asambleja e përgjithshme zgjedh një ose më shumë persona fizike si administratorë të shoqërisë për një periudhë pesë vjeçare (5 vjet), në pajtim me parashikimet e Ligjit 9901 datë 14.04.2008, i ndryshuar. Emërtimet do të jenë individuale dhe sipas një vendimi të marrë me shumicë të zakonshme nga Asambleja e Përgjithshme.

Administrator i shoqërisë "DarkCore Technology & Software" sh.p.k. është Z. Z. Denis Malushi, shtetas shqiptar, lindur dhe banues në Tiranë, i datëlindjes 17.05.1987, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, pajisur me ID/Pasaportë nr.personal: I70517116P.

Kreu IV
Dispozitat Përfundimtare.

Neni 7

Marrëdhëniet e punësimit në shoqëri do të rregullohen nëpërmjet kontratës së punësimit që lidhet midis palëve në mbështetje të Kodit të Punës si dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

Mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë ushtrimit të veprimtarisë private, midis ortakëve, punonjësve dhe personave të tretë, kur ato nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim, mbetet në kompetencë të Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Shoqëria do të ketë vulën e saj ku janë përcaktuar dhe inicialet e emërtimit tregtar. Modalitetet për ndryshimin dhe kompetencat e administratorit, kompetencat dhe marrja e vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme, zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit themeltar, etj, do të rregullohen nga Statuti i Shoqërisë dhe Ligji 9901 14.04.2008 "2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar si dhe Ligji 9723, datë 03.05.2007 "Për Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit", i ndryshuar. Ky akt themelimi është përpiluar në tre kopje me vlerë të njëjta me origjinalin.

Tiranë, më datë 15.01.2025.

ORTAKU THEMELUES

DENIS MALUSHI

